REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL

Adresa: "Sulejman Delvina" Nr. 1, Tiranë. Tel / Fax: +355 4 2223969, Email: info@acaa.gov.al

Nr. Prot 469 Datë 29 /03/ 2016

Vendim

Nr 2 , Datë 29 / 03 / 2016

Për miratimin e procedurës së jashtme së zbatimit të rregullave për raportimin e detyrueshëm të ngjarjeve në aviacionin civil, Rishikimi 1

Në zbatim të Nenit 13, pika a dhe pika g, të Ligjit Nr. 10 233, datë 11.2.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", i ndryshuar: Urdhëri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 68, datë 10.06.2011 "Për miratimin e rregullores mbi Raportimin e Ngjarjeve në Aviacionin Civil". Urdhëri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 123, datë 22.11.2011 "Për miratimin e Rregullores për integrimin në një baze qendrore të informacionit për ngjarjet në Aviacionin Civil dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara".

Vendosa:

1. Miratimin e procedurës së jashtme të zbatimit të rregullave për Raportimin e Detyrueshëm të Ngjarjeve në Aviacionin Civil, Rishikimi 1.
2. Vendimi i Drejtorit Ekzekutiv Nr.7 date:18.03.2013 "Per miratimin e procedures se jashtmese zbatimit te rregullave per raportimin e detyrueshem te ngjarjeve ne aviacionin civil" , shfuqizohet.
3. Subjektet raportuese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi duhet të zbatojnë parashikimet e kësaj procedure, në përmbushje të detyrimeve të tyre për raportimin e ngjarjeve.

4. Ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë në Autoritetin e Aviacionit Civil, të bashkërendojë punën me Drejtoritë e tjera të Autoritetit të Aviacionit Civil si dhe me subjektet raportuese apo të interesuara për informacionin e raportuar, në funksion të zbatimit të kësaj procedure.
5. Ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë në bashkëpunim me sektorin e Informacionit, të marrë masa për publikimin për raportimin e ngjarjeve në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit te Aviacionit Civil.

Të merren masa për shpërndarjen tek Operatorët që janë subjekt i kësaj procedure.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas datës së miratimit dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit te Aviacionit Civil.

Aleksander LIPIVANI

DREJTOR EKZEKUTIV

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES

Autoriteti i Aviacionit Civil

PROCEDURE E JASHTME E ZBATIMIT TË RREGULLAVE PËR RAPORTIMIN E DETYRUESHËM TË NGJARJEVE NË AVIACIONIN CIVIL

RISHIKIMI 1

SHKURT 2016

Hyrje

Ky dokument është pronë e:

Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë

Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1
Pranë Parkut të Delegacioneve
Tiranë / Shqipëri
Po Box 205

Ndalohet çdo riprodhim ose ndryshim i këtij materiali, pa pëlqim me shkrim.

Shpërndarja e pa autorizuar e këtij manuali ose pjesëve të tij, jashtë shpërndarjes zyrtare, sipas përkufizimit të këtij dokumenti, do të cilësohet si shkelje e procedurave të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe do të trajtohet përkatësisht me punonjësin përgjegjës.

Ky individ mund t'i nënshtrohet procedimit ligjor nga institucionet përkatëse ligjore.

Për Autoritetin e Aviacionit Civil:

Drejtor Ekzekutiv

LISTA E FAQEVE EKZISTUESE

Kapitulli	Faqe	Rishikimi	Datë
Hyrje	7	Version 0	18.03.2013
Qëllimi	7	Version 0	18.03.2013
Legjislacioni në fuqi	8	Version 1	23.12.2015
Zbatueshmëria	9	Version 1	23.12.2015
Të dhënat e kontaktit	11	Version 1	23.12.2015
Sistemi Raportimit të Detyrueshem të Ngjarjeve (RDN) pranë AAC	12	Version 0	18.03.2013
Formularët e raportimit të ngjarjeve	13	Version 1	23.12.2015
Mbrojtja e informacionit	14	Version 0	18.03.2013
Përpunimi i raporteve të ngjarjeve dhe publikimi i informacioneve të Sigurisë	14	Version 1	23.12.2015
Lista e operacioneve, mirëmbajtjes, riparimit dhe ngjarjeve që kanë të bëjnë me prodhimin e avionit për t'u raportuar.	16	Version 1	23.12.2015
Format e Raportimit dhe shënime për plotësimin e tyre	33	Version 1	23.12.2015

	Emri dhe pozicioni	Datë	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Elton Kacagjeli, Përgj. Sektori i SMS Edmira Çuko, Inspektor i SMS	09.02.16 09.02.16	
Kontrolluar nga:	Feliks Baci, Drejtor i DKCSMS	11.02.16	
Rishikuar nga:	Edlira Kraja, Drejtor i Standartizimit Teknik	11.02.16	
Miratuar nga:	Aleksander Lipivani, Drejtor Ekzekutiv		

LISTA E SHPËRNDARJES

Përdoruesi	Media/Mediumi	Sasia
Arkivi	Shkresor	1
	Elektronike	1
Intranet	Elektronike	1
DAMO,DMSA,DMAA,DMSHLA, DKCSMS STAF	Elektronike	1

REGJISTËR I RISHIKIMEVE

Nr:	Datë:	Rishikuar nga:	Nr:	Datë:	Rishikuar nga:
1	23.12.2015	Edmira Çuko Elton Kacagjeli			
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					

PËRMBLEDHJE

Kjo procedurë e jashtme është përpiluar në përputhje me:

- Ligjin Nr.10040, datë 22.12.2008 "Për Kodin Ajror të RSH-së", i ndryshuar, Kreu IX i tij
- Ligjin Nr.9658, datë 18.12.2006 që ratifikon Marrëveshjen Shumëpalëshe.
- Urdhëri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 68, datë 10.06.2011 "Për miratimin e rregullores mbi Raportimin e Ngjarjeve në Aviacionin Civil".
- Urdhëri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 123, datë 22.11.2011 "Për miratimin e Rregullores për integrimin në një baze qendrore të informacionit për ngjarjet në Aviacionin Civil dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara".

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje 7

2. Qëllimi 7

3. Legjislacioni në fuqi 8

4. Zbatueshmeria 9

4.1 Kategoria e avionëve të përfshirë 9

4.2 Ngjarjet që duhet të raportohen 9

4.3 Personat që kërkohet të raportojnë 11

4.4 Raportimi vullnetarë 12

5. Të dhënat e kontaktit 12

6. Sistemi Raportimit të Detyrueshëm të Ngjarjeve (RDN) pranë AAC 13

7. Formularët e raportimit të ngjarjeve 14

8. Mbrojtja e informacionit 15

9. Përpunimi i raporteve të ngjarjeve dhe publikimi i informacioneve të Sigurisë 15

9.2 Ngjarjet e mbyllura përpara afatit të raportimit 16

10. ANEKSI A 17

11. ANEKSI B 34

1. Hyrje

Urdhri i Ministrit Nr.68, datë 10.06.2011 "Për miratimin e rregullores mbi Raportimin e detyrueshëm të Ngjarjeve në Aviacionin Civil", kërkon nga çdo person i specifikuar në nenin 4, të raportojë ngjarjet që kanë të bëjnë me sigurinë në aviacion dhe këto ngjarje të mblidhen nga Autoriteti i Aviacionit Civil, duke krijuar kështu bazën e të dhënave që do shërbejë për mbledhjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e këtyre ngjarjeve.

Objektivi i vetëm i raportimit të ngjarjeve është të kontribuojë në përmirësimin e sigurisë ajrore dhe të mos atribuojë faj apo detyrim.

Për këtë qëllim Autoriteti i Aviacionit Civil promovon një "Kulturë të Drejtë"/ "Just Culture tek të gjitha fushat e komunitetit të aviacionit, që do të thotë një kulturë në të cilën individët nuk dënohen për veprimet, lëshimet apo vendimet e ndërmarra nga ata dhe që kanë të bëjnë me përvojën e tyre, trajnimet apo kualifikimet, por që kanë të bëjnë me raportimin e ngjarjes për neglizhencë, shkelje me dashje dhe aktet destruktive që nuk duhet të tolerohen.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë konfidencialitetin e informacionit si dhe të marrë mbrojtjen e këtij informacioni siç tregohet në paragrafin 8 të kësaj procedure.

2. Qëllimi

Qëllimi i kësaj procedure është të përshkruajë sistemin e vendosur për raportimin e ngjarjeve dhe të përcaktojë procedurat për raportimin e detyrueshëm të ngjarjeve në Autoritetin e Aviacionit Civil, nga personat e përcaktuar në nenin 4 të Urdhrit të Ministrit Nr. 68 datë 10.06.2011 "Për miratimin e rregullores mbi Raportimin e detyrueshëm të Ngjarjeve në Aviacionin Civil".

3. Legjislacioni në fuqi

Në kuadrin ligjor shqiptar, Ligji Nr.10040, datë 22.12.2008 "Për Kodin Ajror të RSH-së", i ndryshuar, Kreu IX i tij, përbën bazën ligjore për aktet që rregullojnë çështjen e Raportimit të Ngjarjeve.
Në zbatim të Kodit Ajror dhe Ligjit Nr.9658, datë 18.12.2006 që ratifikon Marrëveshjen Shumëpalëshe, janë miratuar dy akte që rregullojnë drejtpërdrejtë raportimin e detyrueshëm të ngjarjeve:

• Urdhri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 68, datë 10.06.2011 "Për miratimin e rregullores mbi Raportimin e Ngjarjeve në Aviacionin Civil", që kërkon nga Autoriteti i Aviacionit Civil të mbledhë raportet, vlerësojë procesin dhe të ruajë të dhënat në lidhje me ngjarjet që do të raportohen nga personat e përcaktuar në Nenin 4 të këtij Urdhri.

• Urdhri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 123, datë 22.11.2011 "Për miratimin e Rregullores për integrimin në një bazë qëndrore të informacionit për ngjarjet në Aviacionin Civil dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara".

Përveç akteve nënligjore të posaçme për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil, kjo çështje rregullohet edhe në aktet e mëposhtme:

• Urdhri i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr.149, datë 02.04.2014 "Për miatimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të zbatimit të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të avioneve dhe të produkteve që kanë lidhje me ta, pjeseve dhe pajisjeve, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit" dhe konkretisht, në pikën 21A.165 (f) parashikohen përgjegjësitë në organizatat e prodhimit për raportimin e artikujve të lëshuar të cilat mund të çojnë në një gjendje të pasigurt.

• Urdhri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr.110, datë 10.02.2012 "Për miratimin e rregulloreve mbi vlefshmerinë ajrore të produkteve, pajisjeve aeronautike dhe pjeseve të

avioneve si dhe miratimin e organizatave dhe personelit të perfshirë në këto detyra" ku parashikohet përgjegjësia e individit apo organizatës për vlefshmërinë ajrore të një avioni.

- Urdhri i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr.151, datë 09.04.2014 "Për miratimin e rregullores për kërksat teknike dhe procedurat administrative në fushën e aviacionit civil" ku parashikohen detyrimet e Operatorëve Ajrorë në lidhje me raportimin e ngjarjeve duke u referuar në OPS 1.420.
- Urdhri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr.115, datë 23.10.2012 "Për miratimin e rregullores mbi kërkesat e përbashkëta për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror" ku parashikohen referenca për raportimin e ngjarjeve tek autoritetet kompetente.
- Urdhri i Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Nr.19, datë 16.10.2008 "Për Raportimin dhe Vlerësimin e Ngjarjeve të Sigurisë në Menaxhimin e Trafikut Ajror".
- Urdhëri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 130, datë 11.09.2012, "Rregullore për certifikimin, regjistrimin e Aerodromeve dhe përgjegjësite operative që bien mbi operatoret e aerodromeve".

4. Zbatueshmeria

4.1 Kategoria e avionëve të përfshirë

Operatoret që ofrojnë shërbime për avionët të cilët operojnë mbi apo në Shqipëri, duhet të raportojnë çdo ngjarje e cila plotëson kriteret e kërkuara pavarësisht kombësisë së avionit të përfshirë në këtë ngjarje.

4.2 Ngjarjet që duhet të raportohen

Me ngjarje, nënkuptojmë një ndërprerje e operimit, defekt, gabim ose rrethanë tjetër e pazakontë e cila ka ose mund të ketë ndikuar mbi sigurinë e fluturimit, e cila nuk ka rezultuar në një aksident ose incident serioz.

Një ngjarje e raportueshme e lidhur me operimin e një avioni, përfshin çdo incident që rrezikon ose i cili nëse nuk korrigjohet, rrezikon avionin, pasagjerët në të ose ndonjë person tjetër.
Një listë me shembuj të këtyre ngjarjeve është paraqitur në Aneksin A të kësaj procedure.

4.3 Personat që kërkohet të raportojnë

Urdhri i Ministrit Nr. 68, datë 10.06.2011 "Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil", nenin 4 i tij përcakton kategoritë e personave (ose organizatave), të cilëve u kërkohet të raportojnë ngjarjet e identifikuara në nenin 3 të këtij urdhri.
Këtu përfshihen:
a) operatori ose administratori i një mjeti fluturues me turbinë ose një avioni të transportit publik të përdorur nga një Operator, për të cilin Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar siguron mbikqyrjen e sigurisë së operacioneve;
b) një person i cili ushtron biznesin e projektimit, prodhimit, ruajtjes apo modifikimit të një avioni të transportit publik ose me turbinë ose të ndonjë pajisje ose pjesë të tyre, nën mbikqyrjen e Autoritetit të Aviacionit Civil;
c) një person i cili nënshkruan një çertifikatë të inspektimit të mirëmbajtjes, ose lëshimit për shërbim (release to service) në lidhje me një mjet fluturues turbinë ose një avion të transportit publik, apo ndonjë pajisje ose pjesë të tyre, nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Aviacionit Civil;
d) një person i cili kryen një funksion që i kërkon atij të jetë i autorizuar nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil, si një kontrollues i trafikut ajror ose si një oficer i informacionit të fluturimit;
e) një menaxher i një aeroporti në bazë të Urdhrit të Ministrit Nr. 130, datë 11.09.2012, "Rregullore për certifikimin, regjistrimin e Aerodromeve dhe përgjegjësite operative që bien mbi operatoret e aerodromeve";
f) një person i cili kryen një funksion të lidhur me instalimin, modifikimin, mirëmbajtjen, riparimin, rregullimin, kontrollin e fluturimit ose inspektimin e paisjeve të navigacionit ajror, për të cilin është përgjegjës Autoriteti i Aviacionit Civil;
g) një person i cili kryen një funksion të lidhur me shërbimet në tokë të avionëve, duke përfshirë furnizimin me karburant, përgatitjen e dokumentave të fluturimit (loadsheet), ngarkimin, shkrirjen e akullit dhe tërheqje-shtyrjen (pushback) në një aeroport.

4.4 Raportimi vullnetarë

Përveç sistemit të raportimit të detyrueshëm, Autoriteti i Aviacionit Civil ka inkurajuar dhe sistemin e raportimit vullnetar me qëllim mbledhjen dhe analizimin e informacionit mbi mungesat e vërejtura në aviacion, të cilat nuk kërkohen të raportohen sipas sistemit të detyrueshëm të raportimit, por të cilat përceptohen nga raportuesi si një rrezik aktual ose potencial.

Ndonëse aktet nënligjore në fuqi vendosin mbi individët, përgjegjësitë kryesore për raportimin e ngjarjeve, në interes të sigurisë së aviacionit, Autoriteti i Aviacionit Civil inkurajon, përdorimin e sistemeve të raportimit të organizatave.

Në një rast të tillë, organizata e miratuar do të vendosë një procedurë për njoftimin në Autoritetin e Aviacionit Civil të ngjarjeve. Kjo procedurë, që është zakonisht pjesë e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë, duhet të identifikojë personin përgjegjës brenda organizatës duke e nominuar për të marrë të gjitha raportet dhe për të selektuar ato raporte të cilat i plotësojnë kriteret e një ngjarjeje që duhet të raportohet në Autoritetin e Aviacionit Civil. Procedura duhet të përfshijë parashikime, të cilat sigurojnë që punonjësi është informuar nëse një raport i bërë nga ai nuk ka kaluar në Autoritetin e Aviacionit Civil si një raportim ngjarjeje, duke i dhënë atij të drejtën të kërkojë që raporti të kalohet në Autoritetin e Aviacionit Civil, ose ta raportojë atë direkt.

5. Të dhënat e kontaktit

5.1 Format e ngjarjeve[1] duhet të dërgohen në sektorin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë në Autoritetin e Aviacionit Civil. Zakonisht raportimi i ngjarjeve bëhet me e-mail, por fax dhe hard copy (dërgimi me postë) janë gjithashtu forma të pranueshme.

[1] Janë të publikara në website-in e AAC-së.

Email	**mor@acaa.gov.al**	Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë
Fax	**+ 355 (0) 42 22 39 69**	Autoriteti i Aviacionit Civil
Tel	**+ 355 (0) 42 25 12 20**	Autoriteti i Aviacionit Civil
Adresa postare	**Autoriteti i Aviacionit Civil**	Adresa e Autoritetit të Aviacionit Civil

Rr. "Sulejman Delvina"

Pranë Parkut të Delegacioneve, Nr.1, Kati II

1001, Tiranë, Albania

Për raportimin vullnetar, një formë e veçantë është krijuar dhe është në dispozicion në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

5.2 Ngjarjet të cilat konsiderohen të rrezikshme ose potencialisht të rrezikshme duhet të raportohen menjëherë në Autoritetin e Aviacionit Civil. Për raportimin e këtyre ngjarjeve mund të përdoret edhe numri i telefonit. Në të gjitha rastet, detajet në lidhje me ngjarjet duhet të dërgohen sa më shpejt të jetë e mundur, mundësisht me e-mail ose fax.

6. Sistemi Raportimit të Detyrueshëm të Ngjarjeve (RDN) pranë AAC

Duke marrë parasysh se objektivi i Raportimit të Detyrueshëm të Ngjarjeve është përmirësimi i sigurisë ajrore dhe sigurisë në Aviacion, Autoriteti i Aviacionit Civil ka ngritur një sistem për mbledhjen e të gjitha ngjarjeve të aviacionit, duke përfshirë edhe aksident/incidentet. Ky sistem siguron:

a) mbledhjen dhe regjistrimin në formatin dixhital të raporteve të pranuara;

b) mos-identifikimin e të dhënave personale të personave të përfshirë në ngjarje, me qëllim mbrojtjen e tyre;

c) përmbledhjen e të dhënave të mbledhura për hartimin e raporteve statistikore;

d) ndarjen e të dhënave me Organin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore;

e) shpërndarjen e informacioneve të sigurisë, kur kërkohet, në Komisionin Europian.

Sistemi RDN shqiptar është i bazuar në ECCAIRS Software, i zhvilluar dhe i shpërndarë nga Qendra Kërkimore e Komisionit Evropian për të ndihmuar autoritetet kompetente në mbledhjen, ndarjen dhe analizimin e informacionit të tyre të sigurisë.

7. Formularët e raportimit të ngjarjeve

Për të lehtësuar raportimin e vazhdueshëm dhe ruajtjen e tyre si dhe analizat e të dhënave, janë hartuar dhe do të zbatohen format e mëposhtme:

1. Formulari ACAA-MOR_1: do të përdoret për të gjitha llojet e ngjarjeve, me përjashtim të ngjarjeve të trafikut ajror, ngjarjeve të raportuara nga kontrollorët e trafikut ajror dhe ngjarjeve në terren për pajisjet navigacionale të raportuara nga inxhinieret e Trafikut Ajror.
2. Formulari ACAA-MOR_2 : do të përdoret vetëm nga ana e Kontrollorëve të Trafikut Ajror për raportimin e ngjarjeve.
3. Formulari ACAA-MOR_3: do të përdoret vetëm nga inxhinierët e Trafikut Ajror për të gjitha ngjarjet lidhur me shërbimet në terren të paisjeve.
4. Formulari ACAA-MOR_4: do të përdoret vetëm nga stafi i Aeroporteve dhe Sigurisë për të gjitha ngjarjet që kanë të bëjnë me shërbimet Aeroportuale dhe ato ngjarje që kanë lidhje me Sigurinë.
5. Formulari ACAA-MOR_5: do të përdoret vetëm nga stafi i Aeroporteve, për ngjarjet që kanë të bëjnë me sulmet nga zogjtë (birdstrike).
6. Formulari ACAA-MOR_6: do të përdoret vetëm nga stafi i Aeroporteve, për ngjarjet që kanë të bëjnë me mallrat e rrezikshëm.

Formularët janë gjithashtu në dispozicion në version elektronik në faqen e internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

**Këto formulare gjenden bashkelidhur kësaj procedure në Aneksin B, së bashku me shpjegime të shkurtra për plotësimin e tyre.*

Raportet duhet të dorëzohen brenda 72 orëve që nga ndodhja e ngjarjes, përveç rrethanave të jashtëzakonshme që mund ta pengojnë këtë dorëzim brenda afatit. Megjithatë, kur rrethanat e ngjarjes gjykohen të jenë të rrezikshme, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të njoftohet për detajet thelbësore sa më shpejt të jetë e mundur.

8. Mbrojtja e informacionit

8.1 Sipas Urdhrit të Ministrit Nr.68, datë 10.06.2011 "Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil", Autoriteti i Aviacionit Civil siguron konfidencialitetin e duhur të informacionit të marrë dhe nuk do të zbulojë emrin e personit që dorëzon raportin apo të një personi të përfshirë në të, përveç rasteve kur i kërkohet ta bëjë këtë me ligj, ose në rastet kur vetë personi në fjalë autorizon me shkrim nxjerrjen e informacionit.

8.2 Autoriteti i Aviacionit Civil siguron që, pavarësisht nga lloji dhe klasifikimi i ngjarjes si aksident apo incident serioz, të dhënat personale të raportuesit nuk duhet të regjistrohen në bazën e të dhënave.

8.3 Sipas Urdhrit të Ministrit Nr.68 datë 10.06.2011" Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil" dhe pa cënuar rregullat e aplikueshme të legjislacionit penal, Autoriteti i Aviacionit Civil garanton se në procedurat e Raportimit të Detyruar të Ngjarjeve në rastet e shkeljeve të pa paramenduara ose pa qëllim, nuk do ta vërë raportuesin përpara ligjit vetëm për shkak se ata kanë raportuar ngjarjen, përveç rasteve të neglizhencës së rëndë.

8.4 Në mënyrë të ngjashme, Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë që punonjësit, të cilët raportojnë incidente, nuk bëhen subjekt i ndonjë paragjykimi nga punëdhënësi i tyre.

9. Përpunimi i raporteve të ngjarjeve dhe publikimi i informacioneve të Sigurisë

9.1 Autoriteti i Aviacionit Civil do të vlerësojë raportet e ngjarjeve të marra në mënyrë që:

• Të vendosë se për cilat nga këto ngjarje të raportuara të kërkojë hetim;

• Të nxjerrë rekomandime mbi safety-in dhe të verifikojë, kur gjykohet e nevojshme, që organizatat përkatëse të aviacionit kanë ndërmarrë masa rregulluese dhe parandaluese për ngjarjet e raportuara;

• të analizojë informacionin e raportuar në mënyrë që të zbulojë problemet e sigurisë të cilat nuk mund të jenë evidentuar nga raportuesi;

• të kryejë studime statistikore dhe analiza në mënyrë që të identifikohen prirje të rëndësishme që mund të kenë një ndikim në sigurinë dhe të matet risku në bazë të rregulloreve dhe aktiviteteve të mbikqyrjes;

• të vërë në dispozicion informacionin që vjen nga raportet e ngjarjeve dhe rezultatet e studimeve të të dhënave për përmirësimin e sigurisë ajrore;

• të njoftojë ngjarjen tek autoritetet kompetente të shtetit ku ngjarja mund të ketë ndodhur, ku avioni është regjistruar, ku avioni është prodhuar dhe/ose ku është i çertifikuar Operatori;

9.2 Ngjarjet e mbyllura përpara afatit të raportimit

Në këtë kategori klasifikohet ato ngjarjet të cilat plotësojnë kriteret për një ngjarje që duhet raportuar dhe që janë trajtuar nga organizata raportuese (ku nga raportet duket qartë se procedurat, dokumentacioni, etj si dhe veprimet e raportuesit kanë mbajtur në kontroll riskun e identifikuar, trajtuar dhe mbyllur). Për këto ngjarje nuk kërkohet hetim i mëtejshëm nga Autoriteti i Aviacionit Civil, pavarësisht se informacioni i raportuar duhet regjistruar në databazën.

Që një ngjarje të klasifikohet e mbyllur nga Autoriteti i Aviacionit Civil duhet që informacioni që përmbanë raporti, në veçanti informacioni mbi veprimet e ndërmarra nga organizata raportuese të vërtetojnë kontrollin e situatës.

10. ANEKSI A

Lista e operacioneve, mirëmbajtjes, riparimit dhe ngjarjeve që kanë të bëjnë me prodhimin e avionit për t'u raportuar.

Shënimi 1: Edhe pse kjo Shtojcë radhit shumicën e ngjarjeve të raportueshme, ajo nuk mund të jetë tërësisht gjithëpërfshirëse. Çdo ngjarje tjetër, të cilat gjykohen nga personat e përfshirë si brënda kritereve, duhet gjithashtu të raportohen.

Shënimi 2: Kjo Shtojcë nuk përfshin aksidentet. Përveç kërkesave të tjera mbi njoftimin e aksidenteve, aksidentet duhet gjithashtu të regjistrohen në bazën e të dhënave të përmëndur në Nenin 5 (2).

Shënim 3: Kjo Shtojcë përmban shembuj të kërkesave të raportimit mbi operimin, mirëmbajtjen, riparimin dhe prodhimin e avionëve.

Shënimi 4: Ngjarjet për t'u raportuar janë ato ku siguria e operimit ishte ose mund të ishte rrezikuar ose mund të kishte çuar në një situatë të pasigurtë.

Nëse, sipas mendimit të raportuesit, një ngjarje nuk rrezikoi sigurinë e operimit por, nëse përsëritej në rrethana të ndryshme e të njëjta, do të përbënte një rrezik, atëherë një raport duhet të përgatitet. Ajo që gjykohet e raportueshme për një kategori prodhimi, pjesë ose pajisje mund të mos jetë e tillë për një tjetër dhe mungesa ose prezenca e një faktori të vetëm, njerëzor ose teknik, mund të transformoj një ngjarje në një aksident ose incident seriozë.

Shënimi 5: Aprovime specifike operacionale, p sh. RVSM, ETOPS, RNAV, ose një program projektimi ose mirëmbajtje, mund të ketë kërkesa specifike raportuese mbi dështimet ose keqfunksionimet e lidhura me aprovimin ose programin në fjalë.

PERMBAJTJA

A: OPERACIONET E FLUTURIMIT TË AVIONIT

B: AVIONI NGA ANA TEKNIKE

C: MIRËMBAJTJA E AVIONIT DHE RIPARIMI

Ç: SHËRBIMET E NAVIGIMIT AJROR, LEHTËSIRAT DHE SHËRBIMET NË TERREN

A. OPERACIONET E FLUTURIMIT TË AVIONIT

(i) Operimi i Avionit

(a) Manovrat e shmangies:

- të rrezikut të përplasjes me një avion tjetër, me tokën ose objekt tjetër ose të një situatë të pasigurtë kur veprimi i shmangies do të ishte i përshtatshëm;
- një manovër shmangie që kërkohet për të mënjanuar përplasjen me një avion tjetër, me tokën ose objekt tjetër.
- një manovër mënjanuese për të shmangur situata të tjera të pasigurta.

b) Incidente të uljes ose të ngritjes, përfshirë uljet e detyruara ose parandaluese. Incidente si mos mbërritja në pistë, kalimi i pistës ose dalje anësore nga pista. Ngritje, ngritje të refuzuara, ulje ose tentativa për të uluar në një pistë të mbyllur, të zënë ose të gabuar. Inkursione të pistës.

(c) Pamundësia për të arritur performancën e parashikuar gjatë ngritjes ose ngjitjes fillestare.

(ç) Sasi karburanti në nivel kritik dhe pamundësia për të transferuar karburant ose për të përdorur sasinë totale të karburantit që mund të përdoret.

(d) Humbja e kontrollit (përfshirë atë të pjesshëm ose të përkohshëm) pamvarësisht nga shkaku.

(dh) Ngjarjet pranë ose mbi V1 që rrjedhin nga ose krijojnë një situatë të rrezikshme ose potencialisht të rrezikshme (psh. ngritje të refuzuara, goditje e bishtit, humbja e fuqisë motorike etj.).

(e) Të ecurit që krijojnë një situatë të rrezikshme ose potencialisht të rrezikshme.

(ë) Devijim i rëndësishëm i paqëllimshëm prej shpejtësisë ajrore, trajektores së përcaktuar ose lartësisë (më shumë se 300 feet) pamvarësisht nga shkaku.

(f) Ulje nën lartësinë/altitudën e përcaktuar ose ulje në minimum e lartësisë/altitudës pa referimin vizual të kërkuar.

(g) Humbja e vendndodhjes lidhur me vendndodhjen aktuale ose avionë të tjerë.

(gj) Humbja/ngjarje e komunikimit ndërmjet ekuipazhit të fluturimit (CRM) ose ndërmjet ekuipazhit të fluturimit dhe palëve të tjera (ekuipazhit të kabinës, ATC, teknik).

(i) Ulje e pa përballueshme/problematike -një ulje që gjykohet të kërkoj një "kontroll të uljes problematike".

(j) Tejkalimi i caqeve të luhatjes së karburantit.

(k) Caktimi i gabuar i një kodi SSR ose të një nënshkalle të lartësimatësit.

(l) Programim i gabuar i ose futja e të dhënave të gabuara në një pajisje që përdoret për navigim ose përllogaritjen e performancës ose përdorimin e të dhënave të gabuara.

(m) Marrja ose interpretimi i gabuar i mesazheve radio-telefonike.

(n) Defekte ose keqfunksionime të sistemit të karburantit të cilat kanë ndikuar mbi furnizimin me karburant dhe/ose shpërndarjen.

(nj) Avion që niset nga një sipërfaqe e shtruar aksidentalisht.

(o) Përplasje ndërmjet një avioni dhe një avioni tjetër, automjeti ose objekti tjetër në tokë.

(p) Operim i pavemëndshëm dhe/ose i gabuar i ndonjë prej rregullatorëve.

(q) Pamundësia për të arritur konfigurimin e duhur të avionit për çdo fazë të fluturimit (psh. marshi i uljes, kapaku i marshit, stabilizues, paretet etj.).

(r) Një rrezik ose rrezik i mundshëm i cili ndodh si pasojë e çdo simulimi të qëllimshëm të kushteve të pafavorshme për trajnim, kontrolle të sistemit ose për qëllime trajnimi.

(rr) Lëkundje jo normale.

(s) Operimi i çdo sistemi primar të paralajmërimit që ka të bëj me manovrimin e avionit psh. paralajmërimi i konfigurimit, paralajmërimi i kalimit të shpejtësisë etj përjashto rastet kur:

1. ekuipazhi përfundimisht vendos që të dhënat ishin të gabuara dhe me kusht që paralajmërimi i gabuar të mos ketë rezultuar në vështirësi ose rrezilshmëri për shkak të reagimit të ekuipazhit ndaj paralajmërimit; ose

2. operohet për trajnim ose qëllime testimi

(sh) "Paralajmërimi" GPWS/TAWS kur:

1. avioni i afrohet më shumë tokës sesa është planifikuar ose parashikuar, ose

2. paralajmërimi vërehet në kushtet meteorologjike të instrumentit ose natën dhe përcaktohet të jetë shkaktuar nga shkalla e lartë e uljes (model 1); ose

3. paralajmërimi rezulton nga dështimi për të zgjedhur marshin e uljes prej pikës së duhur në përdorim; ose

4. çdo vështirësi ose rrezik shkaktohet ose mund të shkaktohet si pasoj e reagimit të ekuipazhit ndaj "paralajmërimit"psh. shkëputje e vogël e mundshme nga trafiku tjetër. Kjo mund të përfshij paralajmërimin e çdo modeli ose tipi, dmth. të vërtetë ose të gabuar.

(u) "alarmi" GPWS/TAWS kur çdo vështirësi ose rrezik shkaktohet ose mund të shkaktohet si pasojë e reagimit të ekuipazhit ndaj "alarmit".

(aa) ACAS RA-s

(bb) Incidente në motor ose shpërthim në helikë që rezultojnë në dëmtim të madh ose serioz.

(ii) Emergjenca

(a) Zjarr, shpërthim, tym ose avuj toksikë ose të dëmshëm edhe pse zjarret janë shuar.

(b) Përdorimi i çdo procedure jo standarte nga ana e ekuipazhit të kabinës ose të fluturimit për të përballuar një emergjencë kur:

1. procedura egziston por nuk vihet në zbatim;
2. procedura nuk egziston;
3. procedura egziston por nuk është e plotë ose e përshtatshme;
4. procedura është e gabuar;
5. procedura e gabuar është përdorur.

(c) Pamjaftueshmëria e çdo procedure e planifikuar për t'u përdorur në rast emergjence përfshirë kur përdoret për mirëmbajtje, trajnim ose qëllime testimi.

(ç) Një ngjarje e cila çon në një evakuim emergjence.

(d) Ulja e presionit

(dh) Përdorimi i çdo pajisje emergjence ose procedure emergjence të parashikuar me qëllim përballimin e një situate.

(e) Një ngjarje e cila çon në shpalljen e emergjencës ("Mayday" ose "panne").

(ë) Dështimi i një sistemi ose pajisje emergjence përfshirë të gjitha dyert e daljes dhe ndiçimit për të funksionuar në mënyrë të kënaqshme përfshirë përdorimin për mirëmbajtje, trajnim, ose qëllime testimi.

(f) Ngjarje të cilat kërkojnë çdo lloj përdorimi të oksigjenit të emergjencës nga ana e njërit prej anëtarëve të ekuipazhit.

(iii) Paaftësi e ekuipazhit

(a) Paaftësi e një anëtari të ekuipazhit të fluturimit përfshirë atë të ndodhur para nisjes nëse konsiderohet se mund të kishte rezultuar në paaftësi mbas ngritjes.

(b) Paaftësi e një anëtari të ekuipazhit të kabinës e cila bën të pamundur përdorimin e detyrave themelore të emergjencës.

(iv) Plagosje

Ngjarje të cilat çojnë ose mund të çojnë në plagosje serioze të pasagjerëve ose ekuipazhit por të cilat nuk konsiderohen të raportueshme për një ncident.

(v) Meteorologji

(a) Goditje rrufeje e cila rezultoi në dëmtim të avionit ose humbje ose keqfunksionim të një shërbimi themelor.

(b) Goditje breshëri e cila rezultoi në dëmtim të avionit ose humbje ose keqfunksionim të një shërbimi themelor.

(c) Hasja në një turbulencë të madhe e cila shkakton dëmtime tek pasaqjerët ose mendohet se kërkon një "kontroll turbulence" të avionit.

(d) përplasje i xhamit të përparmë

(e) Ndeshje në akull që çon në vështirësi në manovrim, dëmtim të avionit ose humbje ose keqfunksionim të një shërbimi themelor.

(vi) Siguria

(a) Ndërhyrje e paligjshme përfshirë rrezikun e një bombe ose rrëmbimin e avionit.

(b) Vështirësi në kontrollin e pasagjerëve të intoksikuar, të dhunshëm ose të padisiplinuar.

(c) Zbulimi i një udhëtari pa biletë

(vii) Ngjarje të tjera

(a) Shembuj që përsëriten të një lloji specifik ngjarje e cila veças nuk do të konsiderohej "e raportueshme" por, për shkak të frekuencës së shpejtë të saj, paraqet një rrezik potencial.

(b) Një goditje që rezulton në dëmtim të avionit ose humbje ose keqfunksionim të një shërbimi themelor.

(c) Hasja në turbulencë.

(d) Çdo ngjarje tjetër e çdo lloji që konsiderohet të ketë rrezikuar ose të mund të ketë rrezikuar avionin ose personat në bord e tij ose në tokë.

B. AVIONI NGA ANA TEKNIKE

(i) Strukturore

Jo të gjitha dëmtimet strukturore nevojiten të raportohen. Gjykimi teknik kërkohet për të vendosur nëse një dëmtim është aq serioz sa për t'u raportuar. Shembujt e mëposhtëm mund të merren në konsideratë:

(a) dëmtim i një elementi strukturor kryesor (ESK) që nuk është përcaktuar si element që mund të dëmtohet (element me jetëgjatësi të kufizuar). ESK-et janë elementet të cilat kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në fluturim, tokë dhe në mbartjen e ngarkesave dhe dështimi i të cilave mund të çoj në dështim katastrofik të avionit;

(b) defekt ose dëmtim që kalon caqet e pranueshme të një ESK-eje e cila është përcaktuar si e dëmtueshme;

(c) dëmtimi i ose defekti që kalon tolerancat e lejueshme të një elementi strukturor, dështimi i të cilit mund të zvogëloj ngurtësinë strukturore në një masë të tillë saqë vibrimi i kërkuar, divergjenca ose caqet e kontrollit nuk arrihen më;

(ç) dëmtimi i ose defekti i një elementi strukturor i cili mund të rezultoj në shkëputjen e objekteve të mëdha të cilat mund të dëmtojnë personat në avion.

(d) dëmtimi i ose defekti i një elementi strukturor i cili mund të rrezikoj operimin e sistemeve. Shiko (ii) më poshtë;

(e) Humbja e një pjese të strukturës së së avionit gjatë fluturimit.

(ii) Sistemet

Kriteret e përgjithshme të aplikueshme të të gjitha sistemeve propozohen si më poshtë:

(a) humbja, keqfunksionimi serioz ose defekti i një sistemi, nënsistemi ose grup pajisjesh kur procedurat e standarteve operuese, udhëzimet etj. nuk mund të arrihen në mënyrë të kënaqshme;

(b) paaftësia e ekuipazhit për të kontrolluar sistemin, për shembull:

1. veprime të pakomanduara;
2. përgjigje e gabuar dhe/ose jo e plotë përfshirë kufizimin e lëvizjes ose ngurtësisë;
3. largim;
4. dëmtim ose shkëputje mekanike;

(c) dështim ose keqfunksionim i funksion/eve të veçanta të sistemit (një sistem mund të integroj disa funksione);

(ç) interferencë brënda ose ndërmjet sistemeve;

(d) dështim ose keqfunksionim i mekanizmit mbrojtës ose sistemit të emergjencës që ka të bëj me sistemin;

(dh) Humbja e operimit të sistemit;

(e) Çdo ngjarje që rezulton nga veprimi i paparashikuar i një sistemi.

(ë) Për tipe avionësh me sisteme kryesore unike, nënsisteme ose grup pajisjesh: humbje, keqfunksionim serioz ose defekt i më shumë se një sistemi kryesor, nënsistemi ose grup pajisjesh.

(f) Operimi i çdo sistemi paralajmërues parësor që ka të bëj me sistemet e avionit ose pajisjet përjashto rastet kur ekuipazhi përfundimisht vendos se treguesi ishte i gabuar me kusht që paralajmërimi i gabuar nuk ka çuar në vështirësi ose rrezik që rrjedh nga përgjigja e ekuipazhit ndaj paralajmërimit.

(g) Rrjedhje lëngjeve hidraulike, karburantit, vajit ose lëngjeve të tjera që ka çuar në rrezik zjarri ose ndotje të rrezikshme të mundshme të strukurës së avionit, sistemeve ose pajisjeve ose rrezik për personat në bord.

(gj) Keqfunksionim ose defekt i çdo sistemi tregues kur kjo çon në mundësinë e treguesve çorientues për ekuipazhin.

(i) Çdo dështim, keqfunksionim ose defekt nëse ndodh në një fazë kritike të fluturimit dhe ka të bëj me operimin e sistemit.

(j) Rënje e ndjeshme e performancave aktuale krahasuar me performancën e miratuar që ka rezultuar në një situatë të rrezikshme (duke marrë në konsideratë saktësinë e metodës së përllogaritjes së performancës) përfshirë veprimin frenues, konsumin e karburantit etj.

(k) Asimetri e komandimit të fluturimit; psh. pjesa e krahëve/flap, paret, pjese që ndihmon uljen/ngritjen.

Shtesa e kësaj Shtojce paraqet një list të shembujve të ngjarjeve të raportueshme që rezultojnë nga aplikimi i këtyre kritereve të përgjithshme kundrejt sistemeve specifike.

(iii) Forca shtytëse (përfshirë motorin, helikat dhe sistemet rotor) dhe njësitë ndihmëse të fuqisë (NJNF)

(a) Nxehje, fikje ose keqfunksionim i ndonjë motori.

(b) Tejkalimi i shpejtësisë ose paaftësia për të kontrolluar çdo komponent alternues të shpejtësisë së lartë (për shembull: NJNF, mekanizmi i ciklit të ajrit, turbina me ajër, helika ose rotori).

(c) Dështim ose keqfunksionim i ndonjë pjese të motorit që rezulton në një ose më shumë nga pasojat e mëposhtme:

1. mospërmbajtje të komponenteve/copërave;

2. zjarr i pakontrolluar i brendshëm ose i jashtëm, ose çlirim i gazit të nxehtë;

3. ecje/shtyrje në një drejtim ndryshe nga ai i kërkuar prej pilotit;

4. sistemi i ndryshimit të ecjes/shtyrjes nuk funksionon ose funksionon në mënyrë të shkujdesur;

5. paaftësia për të kontrolluar fuqinë,ecjen/shtyrjen ose rpm;

6. dështim i strukturës mbajtëse të motorit;

7. humbje e plotë ose e pjesshme e një pjese kryesore të motrorit;

8. avuj të dendur të dukshëm ose përqëndrime të produkteve toksike të mjaftueshëm për të bërë të paaftë ekuipazhin ose pasagjerët;

9. paaftësia, me anë të procedurave normale, për të fikur motorin;

10. paaftësia për të ndezur një motor rezervë;

(ç) Një shtyrje/humbje fuqisë e pakomanduar, ndryshim ose oshilacion/lëkundje të cilët klasifikohen si humbje e shtyrjes ose kontrollit të fuqisë (HSHKF):

1. për një avion me një motor, ose

2. atje ku konsiderohet i tepërt për t'u aplikuar; ose

3. atje ku kjo mund të ndikoj mbi më shumë se një motor në një avion me shumë motorë, veçanërisht në rastin e një avioni me dy motorë; ose

4. për një avion me shumë motorë ku i njëjti ose i ngjashëm tip motori përdoret në një aplikim që do të konsiderohej kritik ose i rrezikshëm.

(d) Çdo defekt i një pajisje sigurie e cila del nga funksioni pa plotësuar funksionimin e plotë.

(dh) Defekte të përgjithshme të cilët mund të shkaktojnë shkallë fikje aq të lartë gjatë fluturimit sa egziston mundësia e fikjes së një ose më shumë motorëve në të njëjtin fluturim.

(e) Mosfunksionimi i kufizuesit ose i mekanizmit të kontrollit kur kërkohet ose funksionim i çrregullt i tyre.

(ë) Tejkalim i parametrave të motorit.

(f) FOD që rezulton i dëmtuar.

Helikat dhe transmisioni

(g) Mosfunksionim ose keqfunksionim i ndonjë pjese të helikës që shkakton një ose më shumë:

1. tejkalimi i shpejtësisë i helikës;

2. zhvillimi i zvarritjes së tepërt;

3. një shtytje në anën e kundërt nga ajo e komanduar nga ana e pilotit;

4. çlirimi i helikës ose çdo pjese kryesore të saj;

5. një dështim që çon në mungesë ekuilibri ;

6. lëvizje e paqëllimshme e teheve të helikës nën minimumin e përcaktuar në pozicionin e nivelit të ulët gjatë udhëtimit;

7. paaftësia për të manovruar helikën;

8. ndryshim i pakomanduar i lartësisë;

9. forcë rrotulluese e pakontrollueshme ose luhatje e shpejtësisë;

10. paaftësia për të ndryshuar nivelin e helikës.

11. lëshimi i pjesëve me forcë të ulët;

Rotorët/helikat dhe transmisioni

(gj) Dëmtim ose defekt i kutisë së marsheve kryesore të rotorit të cilat mund të çojnë në shkëputje të rotorit gjatë fluturimit dhe/ose keqfunksionime të kontrollit të tij.

(i) Dëmtim i bishtit të rotorit, transmisionit dhe sistemeve ekuivalente. Njësitë Ndihmëse të Fuqisë (NJNF)

(j) Fikje ose dështim kur NJNF kërkohet të vihet në dispozicion me anë të kërkesave operacionale, psh. ETOPS, MEL.

(k) Paaftësia për të fikur NJNF.

(l) Tejkalimi i shpejtësisë.

(ll) Paaftësia për të ndezur NJNF kur nevojitet për arsye operacionale.

(iv) Faktorët njerëzor.

Çdo incident ku tiparet dhe papërshtatshmëria e konstruksionit të avionit mund të çonte në gabim përdorimi që do të kontribuonte në pasoja të rrezikshme dhe katastrofike.

(v) Ngjarje të tjera

(a) Çdo incident ku tiparet dhe papërshtatshmëria e konstruksionit të avionit mund të çonte në gabim përdorimi që do të kontribuonte në pasoja të rrezikshme dhe katastrofike.

(b) Një ngjarje e cila normalisht nuk konsiderohet e raportueshme (psh. orendi ose pajisje kabine, sistemet e ujit), kur rrethanat rezultojnë të rrezikshme për avionin dhe personat në bord.

(c) Zjarr, shpërthim, tym ose avuj toksikë ose të dëmshëm.

(ç) Çdo ngjarje tjetër e cila mund të rrezikoj avionin ose ndikoj mbi sigurinë e personave në bord ose njerëzve apo pasurisë në afërsi të avionit ose në tokë.

(d) Dështim ose defekt i sistemit të adresave të pasagjerëve që rezulton në humbje ose mosdëgjim të sistemit të adresave të pasagjerëve.

(e) Humbja e kontrollit të ndenjëses së pilotit gjatë fluturimit.

C. MIREMBAJTJA E AVIONIT DHE RIPARIMI

(i) Montim i gabuar i pjesëve dhe komponentëve të avionit të zbuluara gjatë inspektimit ose një procedure testimi që nuk kanë këtë qëllim specifik.

(ii) Rrjedhje e ajrit të nxehtë si pasojë e dëmtimit strukturor.

(iii) Çdo defekt i një pjese që ka kaluar kontrollin për jetëgjatësinë, e cila pushon së operuari para plotësimit të misionit të saj.

(iv) Çdo dëmtim ose përkeqësim (psh. çarje, krisje, korrozion, shkëputje etj.) për shkak të çdo arsye (psh. vibrimit, humbjes së ngurtësisë ose dështimit strukturor) të:

(a) një strukture primare ose një PSE (siç përcaktohet në Manualin e Riparimit të prodhuesit) ku dëmtime ose përkeqësime të tilla kalojnë kufizimet e lejueshme të specifikuara në Manualin e Riparimit dhe kërkojnë një riparim ose zëvëndësim të plotë ose të pjesshëm;

(b) një strukture sekondare e cila për pasojë ka ose mund të ketë rrezikuar avionin;

(c) motorit, helikës ose sistemit të rotorit.

(v) Çdo dështim, keqfunksionim ose defekt i çdo sistemi ose pajisje ose dëmtim apo përkeqësim si pasojë e pajtimit me një rregullore mbi fluturimin ose udhëzimi tjetër detyrues të lëshuar nga një autoritet rregullator kur:

(a) ai zbulohet për herë të parë organizata raportuese që implementon pajtimin; (b) mbi çdo pajtim pasues, ai/defekti tejkalon kufizimet e lejueshme të caktuara në udhëzim dhe/ose të botuara në procedurat e riparimit/korrigjimit.

(vi) Dështimi i një sistemi ose pajisje përfshirë të gjitha dyert e daljes dhe ndriçimin për të funksionuar në mënyrë të kënaqshme përfshirë periudhën e përdorimit për mirëmbajtje ose qëllime testimi.

(vii) egziston mospajtim ose gabime të rëndësishme lidhur me procedurat e kërkuara të mirëmbajtjes.

(viii) egzistojnë produkte, pjesë këmbimi, pajisje dhe lëndë me origjinë të dyshimtë ose të panjohur.

(iv) egzistojnë të dhëna ose procedura për mirëmbajtjen të pamjaftueshme, të gabuara, çorientuese të cilat mund të çojnë në veprime të gabuara në mirëmbajtje.

(x) Çdo dështim, keqfunksionim ose defekt i pajisjeve tokësore që përdoren për testim ose kontroll të sistemeve të avionit dhe pajisjeve kur inspektimi rutinë i kërkuar dhe procedurat e testimit nuk identifikuan qartë problemin kur kjo rezulton në një situatë të rrezikshme.

Ç. SHËRBIMET E NAVIGIMIT AJROR, LEHTËSIRAT DHE SHËRBIMET NË TERREN

(i) Shërbimet e navigimit ajror (SHNA)

Shiko Shtojcën II, listën e ngjarjeve të raportueshme që lidhen me SHNA.

(ii) Aerodromi dhe lehtësirat e tij

(a) Rrjedhje të konsiderueshme gjatë operacioneve të furnizimit me karburant.

(b) Ngarkesa e sasive të gabuara të karburantit të cilat mund të kenë një ndikim të madh mbi rezistencën, perfomancën, ekuilibrin ose fortësinë strukturore të avionit.

(iii) Përpunimi i pasagjerëve, bagazheve dhe ngarkesës.

(a) Ndotje e konsiderueshme e strukurës, sistemeve dhe pajisjeve të avionit që shkaktohen nga mbartja e bagazheve ose ngarkesës.

(b) Ngarkesa e gabuar e pasagjerëve, bagazheve ose kargos të cilat mund të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi masën e avionit dhe/ose ekuilibrin.

(c) Vendosje e gabuar e bagazheve edhe ngarkesës (përfshirë bagazhet e dorës) të cilat mund të rrezikojnë në një mënyrë avionin, pajisjet e tij ose personat në bord apo pengojnë evakuimin e emergjencës.

(ç) Vendosje e gabuar e kontenierëve të ngarkesës ose objekteve të tjera të rëndësishëm të ngarkesës.

(d) Ngarkesa ose tentativë për të ngarkuar mallra të rrezikshme në kundërshtim me rregullat e aplikueshme përfshirë etiketimin ose paketimin e gabuar të tyre.

(iv) Përpunimi dhe shërbimi në terren i avionit

(a) Dështim, keqfunksionim ose defekt i pajisjeve tokësore që përdoren për testim ose kontroll të sistemeve të avionit dhe pajisjeve kur inspektimi rutinë i kërkuar dhe procedurat e testimit nuk identifikuan qartë problemin kur kjo rezulton në një situatë të rrezikshme.

